


Tregtia me pakicë*

Tremujori I 2017

Tiranë, më 13 Qershor: Në tremujorin e parë 2017, indeksi i volumit të shitjeve në tregtinë me pakicë është rritur 2,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016. Krahasuar me tremujorin paraardhës, ky tregues i përshtatur sezonalisht është ulur 3,5 %.

Fig. 1 Indeksi i volumit në tregtinë me pakicë



*INSTAT, duke filluar nga tremujori i parë 2017, ka përditësuar serinë kohore të treguesve të tregtisë me pakicë (në vlerë dhe volum), mbështetur në ndryshimin e numrit të ndërmarrjeve të regjistruara në vitin 2015. Gjithashtu, seria kohore e treguesve paraqitet për herë të parë e përshtatur sezonalisht. (për më tepër shih: shënime metodologjike fq.9)

Ndryshimi vjetor në indeksin e volumit të shitjeve në tregtinë me pakicë


Në tregtinë me pakicë, pa përfshirë këtu tregtinë me pakicë të hidrokarbureve, indeksi i volumit të shitjeve ka pësuar një rritje prej 2 %, kundrejt të njëjtit tremujor të vitit të mëparshëm.

Në grupin “Ushqime, pije, duhan në njësi tregtare jo të specializuara dhe të specializuara”, indeksi i volumit të shitjeve, është ulur 0,2 %, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2016.

Indeksi i volumit të shitjeve, për grupin “Produkte jo-ushqimore në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara (përfshirë tregtinë me pakicë të hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara)”, është rritur në nivelin 3,3 %, kundrejt të njëjtës periudhë të vitit paraardhës, duke dhënë në këtë tremujor ndikimin kryesor në indeksin e volumit të shitjeve në tregtinë me pakicë.

Në grupin “Tregti hidrokarburesh në njësi tregtare të specializuara”, indeksi i volumit të shitjeve është rritur 3,8 %, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2016.


Fig. 2 Indeksi i volumit në tregtinë me pakicë të hidrokarbureve



Ndikimi i grupeve në tregtinë me pakicë

Në terma vjetor indeksi i volumit të shitjeve, në tregtinë me pakicë në tremujorin e parë 2017 është +2,5 %. Grupet të cilat kanë ndikuar janë: grupi “Artikuj jo-ushqimore në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara” +1,2 pikë përqindje; grupi “Tregti me pakicë e Hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara” +0,8 pikë përqindje dhe grupi “Ushqime, pije e duhan në njësi tregtare jo të specializuara dhe të specializuara” +0,4 pikë përqindje.

Fig.3 Ndikimet e grupeve kryesore në Tregtinë me Pakicë



Ndryshimi tremujor në indeksin e volumit të shitjeve i përshtatur sezonalisht në tregtinë me pakicë


Në tremujorin e parë 2017, indeksi i volumit të shitjeve i përshtatur sezonalisht, në grupin e tregtisë me pakicë, pa përfshirë këtu tregtinë me pakicë të hidrokarbureve, është ulur 4,5 % krahasuar me tremujorin e katërt 2016.

Në grupin “Ushqime, pije, duhan në njësi tregtare jo të specializuara dhe të specializuara”, indeksi i volumit të shitjeve përshtatur sezonalisht, është ulur 6,5 %, krahasuar me tremujorin paraardhës.

Indeksi i volumit të shitjeve përshtatur sezonalisht në tregtinë me pakicë, për grupin “Produkte jo-ushqimore në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara (përfshirë tregtinë me pakicë të hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara)”, është ulur në nivelin 3,3 %, kundrejt tremujorit të mëparshëm.

Në grupin “Tregti hidrokarburesh në njësi tregtare të specializuara“, indeksi i volumit të shitjeve përshtatur sezonalisht është ulur 3,1%, kundrejt tremujorit të fundit të 2016.

Fig.4 Ndryshimi tremujori përshtatur sezonalisht në tregtinë me pakicë



Tab. 1 Ndryshimi vjetor i indeksit mesatar tremujor në tregtinë me pakicë dhe tregtinë me pakicë të Hidrokarbureve (papërshtatur sezonalisht)

| NVE Rev.2 | Aktiviteti Ekonomik | I.16 / I.15 | II.16 / II.15 | III.16 / III.15 | IV.16 / IV.15 | I.17 / I.16 |
|---------------|---|-------------|---------------|-----------------|---------------|-------------|
| 47 | Tregti me Pakicë | 4,2 | 6,7 | 6,8 | 8,2 | 2,5 |
| 47 pa 473 | Tregti me Pakicë (Pa përfshirë Tregtinë me pakicë të hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara) | 7,7 | 10,6 | 8,1 | 6,8 | 2,0 |
| 4711;472 | Ushqime, pije e duhan në njësi tregtare të jo të specializuara dhe të specializuara | 7,5 | 8,2 | 10,1 | 5,1 | -0,2 |
| 4719; 474-478 | Artikuj jo-ushqimore në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara | 7,8 | 12,1 | 6,6 | 8,0 | 3,3 |
| 473 | Tregti me pakicë e hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara | -3,0 | -1,1 | 4,3 | 10,7 | 3,8 |

Tab. 2 Ndryshimi vjetor i indeksit mesatar tremujor në tregtinë me pakicë dhe tregtinë me pakicë të hidrokarbureve (përshtatur sezonalisht)

%

| NVE Rev.2 | Aktiviteti Ekonomik | I.16 / I.15 | II.16 / II.15 | III.16 / III.15 | IV.16 / IV.15 | I.17 / I.16 |
|---------------|---|-------------|---------------|-----------------|---------------|-------------|
| 47 | Tregti me Pakicë | 4,3 | 7,0 | 6,4 | 8,2 | 2,6 |
| 47 pa 473 | Tregti me Pakicë (Pa përfshirë Tregtinë me pakicë të hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara) | 7,8 | 11,1 | 7,8 | 6,7 | 2,0 |
| 4711;472 | Ushqime, pije e duhan në njësi tregtare të jo të specializuara dhe të specializuara | 8,1 | 8,4 | 9,3 | 4,9 | 0,2 |
| 4719; 474-478 | Artikuj jo-ushqimore në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara | 7,9 | 12,8 | 6,4 | 7,8 | 3,4 |
| 473 | Tregti me pakicë e hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara | -3,1 | -1,2 | 4,3 | 10,9 | 3,8 |

Tab. 3Ndryshimi tremujor i indeksit mesatar tremujor në tregtinë me pakicë dhe tregtinë me pakicë të Hidrokarbureve (papërshtatur sezonalisht)

%

| NVE Rev.2 | Aktiviteti Ekonomik | I.16 / IV.15 | II.16 / I.16 | III.16 / III.16 | IV.16 / III.16 | I.17 / IV.16 |
|---------------|---|--------------|--------------|-----------------|----------------|--------------|
| 47 | Tregti me Pakicë | -12,0 | 8,9 | 11,7 | 1,1 | -16,6 |
| 47 pa 473 | Tregti me Pakicë (Pa përfshirë Tregtinë me pakicë të hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara) | -14,5 | 8,1 | 9,4 | 5,5 | -18,4 |
| 4711;472 | Ushqime, pije e duhan në njësi tregtare të jo të specializuara dhe të specializuara | -8,4 | 10,6 | 13,9 | -8,9 | -13,0 |
| 4719; 474-478 | Artikuj jo-ushqimore në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara | -17,7 | 6,6 | 6,6 | 15,4 | -21,2 |
| 473 | Tregti me pakicë e hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara | -6,3 | 10,6 | 17,1 | -8,8 | -12,1 |

Tab. 4 Ndryshimi tremujor i indeksit mesatar tremujor në tregtinë me pakicë dhe tregtinë me pakicë të hidrokarbureve (përshtatur sezonalisht)

%

| NVE Rev.2 | Aktiviteti Ekonomik | I.16 / IV.15 | II.16 / I.16 | III.16 / III.16 | IV.16 / III.16 | I.17 / IV.16 |
|---------------|---|--------------|--------------|-----------------|----------------|--------------|
| 47 | Tregti me Pakicë | 1,8 | 2,5 | 3,1 | 0,6 | -3,5 |
| 47 pa 473 | Tregti me Pakicë (Pa përfshirë Tregtinë me pakicë të hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara) | -0,1 | 2,7 | 4,0 | 0,0 | -4,5 |
| 4711;472 | Ushqime, pije e duhan në njësi tregtare të jo të specializuara dhe të specializuara | -2,1 | 2,6 | 5,6 | -1,1 | -6,5 |
| 4719; 474-478 | Artikuj jo-ushqimore në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara | 0,9 | 1,7 | 3,6 | 1,5 | -3,3 |
| 473 | Tregti me pakicë e hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara | 3,6 | 2,9 | 3,4 | 0,7 | -3,1 |

Tab. 5 Ndryshimi vjetor i indeksit mujor në tregtinë me pakicë dhe tregtinë me pakicë të hidrokarbureve (papërshtatur sezonalisht)

| | | % | | |
|---------------|---|---------------|---------------|---------------|
| NVE Rev.2 | Aktiviteti Ekonomik | 01-17 / 01-17 | 02-17 / 02-16 | 03-17 / 03-16 |
| 47 | Tregti me Pakicë | -0,7 | 2,9 | 5,1 |
| 47 pa 473 | Tregti me Pakicë (Pa përfshirë Tregtinë me pakicë të hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara) | -3,0 | 1,8 | 6,8 |
| 4711;472 | Ushqime, pije e duhan në njësi tregtare të jo të specializuara dhe të specializuara | -4,2 | -0,7 | 4,2 |
| 4719; 474-478 | Artikuj jo-ushqimore në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara | -2,2 | 3,4 | 8,6 |
| 473 | Tregti me pakicë e hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara | 5,3 | 5,7 | 0,8 |

Tab. 6 Ndryshimi vjetor i indeksit mujor në tregtinë me pakicë dhe tregtinë me pakicë të hidrokarbureve (përshtatur sezonalisht)

| | | % | | |
|---------------|---|---------------|---------------|---------------|
| NVE Rev.2 | Aktiviteti Ekonomik | 01-17 / 01-17 | 02-17 / 02-16 | 03-17 / 03-16 |
| 47 | Tregti me Pakicë | -0,5 | 3,1 | 5,2 |
| 47 pa 473 | Tregti me Pakicë (Pa përfshirë Tregtinë me pakicë të hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara) | -2,9 | 2,0 | 7,1 |
| 4711;472 | Ushqime, pije e duhan në njësi tregtare të jo të specializuara dhe të specializuara | -4,0 | 0,1 | 4,7 |
| 4719; 474-478 | Artikuj jo-ushqimore në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara | -2,1 | 3,7 | 8,6 |
| 473 | Tregti me pakicë e hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara | 5,4 | 5,6 | 0,6 |

Tab. 7 Ndryshimi mujor i indeksit mujor në tregtinë me pakicë dhe tregtinë me pakicë të hidrokarbureve (papërshtatur sezonalisht)

| | | % | | |
|---------------|---|---------------|---------------|---------------|
| NVE Rev.2 | Aktiviteti Ekonomik | 01-17 / 12-16 | 02-17 / 01-17 | 03-17 / 02-17 |
| 47 | Tregti me Pakicë | -30,3 | 0,0 | 11,5 |
| 47 pa 473 | Tregti me Pakicë (Pa përfshirë Tregtinë me pakicë të hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara) | -35,1 | 2,0 | 12,6 |
| 4711;472 | Ushqime, pije e duhan në njësi tregtare të jo të specializuara dhe të specializuara | -28,2 | 1,5 | 14,7 |
| 4719; 474-478 | Artikuj jo-ushqimore në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara | -38,6 | 2,3 | 11,4 |
| 473 | Tregti me pakicë e hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara | -15,9 | -5,0 | 8,4 |

Tab. 8 Ndryshimi mujor i indeksit mujor në tregtinë me pakicë dhe tregtinë me pakicë të hidrokarbureve (përshtatur sezonalisht)

| NVE Rev.2 | Aktiviteti Ekonomik | % | | |
|---------------|---|---------------|---------------|---------------|
| | | 01-17 / 12-16 | 02-17 / 01-17 | 03-17 / 02-17 |
| 47 | Tregti me Pakicë | -7,2 | 4,2 | 2,0 |
| 47 pa 473 | Tregti me Pakicë (Pa përfshirë Tregtinë me pakicë të hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara) | -9,5 | 4,9 | 1,4 |
| 4711;472 | Ushqime, pije e duhan në njësi tregtare të jo të specializuara dhe të specializuara | -12,7 | 2,6 | 3,3 |
| 4719; 474-478 | Artikuj jo-ushqimore në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara | -8,1 | 6,1 | 3,0 |
| 473 | Tregti me pakicë e hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara | -2,5 | 1,4 | -0,8 |

Tab. 9 Indekset mujore në vlerë dhe volum në tregtinë me pakicë (papërshtatur sezonalisht)

2010=100

| NVE Rev.2 | | Grup 47 | | | | | | | |
|-----------|-------|---------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|--|
| Viti | 2014 | | 2015 | | 2016 | | 2017 | | |
| Muaji | Vlerë | Volum | Vlerë | Volum | Vlerë | Volum | Vlerë | Volum | |
| 1 | 127.4 | 110.1 | 127.2 | 117.0 | 129.9 | 119.3 | 132.8 | 118.4 | |
| 2 | 122.8 | 106.6 | 122.9 | 109.9 | 125.2 | 115.0 | 133.0 | 118.4 | |
| 3 | 133.2 | 115.5 | 134.2 | 118.4 | 137.0 | 125.6 | 149.3 | 132.0 | |
| 4 | 129.2 | 113.0 | 132.5 | 116.6 | 137.1 | 126.2 | | | |
| 5 | 136.3 | 120.0 | 139.5 | 123.7 | 143.1 | 132.0 | | | |
| 6 | 137.6 | 121.7 | 142.4 | 126.8 | 145.2 | 133.6 | | | |
| 7 | 140.1 | 124.6 | 143.7 | 128.2 | 156.3 | 143.6 | | | |
| 8 | 149.8 | 132.9 | 159.8 | 142.9 | 170.8 | 156.0 | | | |
| 9 | 136.8 | 121.3 | 155.3 | 139.0 | 151.8 | 138.1 | | | |
| 10 | 135.9 | 121.0 | 141.7 | 127.2 | 152.4 | 137.4 | | | |
| 11 | 126.4 | 113.2 | 135.9 | 123.3 | 151.2 | 135.1 | | | |
| 12 | 160.6 | 146.8 | 175.2 | 158.4 | 191.0 | 169.9 | | | |

Tab. 10 Indekset mujore në vlerë dhe volum në tregtinë me pakicë të hidrokarbureve (e papërshtatur nga ndikimi stinor)

2010=100

| NVE | | Grup 4730 | | | | | | | |
|-------|-------|-----------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|--|
| Viti | 2014 | | 2015 | | 2016 | | 2017 | | |
| Muaji | Vlerë | Volum | Vlerë | Volum | Vlerë | Volum | Vlerë | Volum | |
| 1 | 208.1 | 160.8 | 191.5 | 169.1 | 161.2 | 147.9 | 178.7 | 155.8 | |
| 2 | 201.0 | 151.8 | 171.1 | 146.4 | 147.4 | 140.1 | 169.8 | 148.0 | |
| 3 | 211.7 | 160.4 | 175.6 | 145.6 | 168.1 | 159.1 | 188.2 | 160.4 | |
| 4 | 208.5 | 159.0 | 191.2 | 155.6 | 166.9 | 159.1 | | | |
| 5 | 221.1 | 169.0 | 213.7 | 172.5 | 179.3 | 166.5 | | | |
| 6 | 229.2 | 175.4 | 217.1 | 172.0 | 187.4 | 169.0 | | | |
| 7 | 234.1 | 179.2 | 229.5 | 180.5 | 211.3 | 189.3 | | | |
| 8 | 276.6 | 211.3 | 263.2 | 211.2 | 242.6 | 217.0 | | | |
| 9 | 231.7 | 177.1 | 198.6 | 163.5 | 193.0 | 172.8 | | | |
| 10 | 214.6 | 165.6 | 188.6 | 156.1 | 200.0 | 175.9 | | | |
| 11 | 190.0 | 149.0 | 177.1 | 151.1 | 190.4 | 167.0 | | | |
| 12 | 219.7 | 185.6 | 196.4 | 170.1 | 212.1 | 185.3 | | | |

Shënime metodologjike

Informacion

INSTAT, duke filluar nga tremujori i parë 2017, publikon Indeks të vlerësimit të volumit në tregtinë me pakicë me disa përditësime metodologjike, si:

- Përditësimi i serive kohore të treguesve të Tregtisë me Pakicë (në vlerë dhe volum), mbështetur në ndryshimin e numrit të ndërmarrjeve të regjistruara në vitin 2016.
- Përshtatja Sezonale dhe Kalendarike të serive kohore

INSTAT, në 2017 publikon Politikat e Revizionimit Statistikor në linkun: http://www.instat.gov.al/media/371719/politika_e_revizionimit.pdf;

Procesi i përditësimit

Në vitin 2015 numri i ndërmarrjeve aktive (jobujqësore) në Regjistrin Statistikor të Ndërmarrjeve u rrit me 20 %, e cila solli për rrjedhojë ndryshim me 15 % të madhësisë së popullatës në fushën e mbulimit në vrojtimin mbi njësitë e Tregtisë me pakicë

Si rrjedhojë e sa më sipër, u krye përditësimi i serive kohore të të dhënave në nivel individual, si edhe peshave përkatëse në nivel të grupuar. Nga këto ndryshime niveli i të dhënave ndryshon, por norma vjetore e ndryshimit mbetet pothuaj e pandryshuar.

Procesi i përditësimit është bërë përmes *benchmarkimit* të të dhënave të përfuara nga Rregjistri Statistikor i përditësuar, 2015, me metodën e shpërndarjes proporcionale (metoda Denton).

Përshtatja sezonale dhe kalendarike

Përshtatja sezonale dhe kalendarike në seritë mujore / tremujore të Tregtisë me pakicë u zbatua duke përdorur si software JDemetra+, versioni 2.1. Model i përzgjedhur për shpërbërjen e serive është X-12 Arima, nënshpërbërjen X-13 në serinë kohore Tremujori I 2005 - Tremujori I 2017. Modeli X-12 Arima bazohet plotësisht mbi mesataren e lëvizëshme. Në serinë e të dhënave është zbatuar shpërbërja e shumëfishtë (multiplikative). Përshtatjet janë në drejtim të ndikimeve sezonale dhe kalendarike në pasqyrimin e statistikave tremujore. Për përshtatjet sezonale të serive është përdorur qasja direkte. Për përshtatjen kalendarike është përdorur specifikimi i ditëve tregtare dhe kalendari kombëtar, duke marrë në konsideratë si festat fikse dhe ato të lëvizshme. Në përshtatjen sezonale janë analizuar edhe ngjarjet e vecanta të ndodhura përgjatë harkut kohor të shtrirjes së serive.

Informacion mbi vrojtimin

Qëllimi - Statistikat tremujore të Tregtisë me pakicë pranë ndërmarrjeve tregtare përshkruajnë ecurinë dhe zhvillimet më të fundit të treguesve ekonomik në njësitë e shitjes me pakicë dhe konsumit të popullatës në vend.

Baza ligjore të cilës i nënshtrohet metodologjia e prodhimi të treguesve të Tregtisë me Pakicë, është rregullorja e Këshillit Evropian numër 1165/98, 19 Maj 1998, e rishikuar, mbi Statistikat Afatshkurtra.

Fusha e mbulimit - Bazuar në aktivitetin kryesor janë përfshirë në vrojtim:

- ndërmarrjet e tregtisë me pakicë grupi 47-NVE Rev.2 (përfashto 47.79-4799)
- tregtia me pakicë e hidrokarbureve grupi 473-NVE Rev. 2

Grupet janë vlerësuar në bazë të përqindjes që secili produkt ose mall ka zenë në shifrën gjithsej të afarizmit të realizuar nga ndërmarrjet. Për kodifikimin e produkteve është përdorur Nomenklatura e Produkteve (NP). Grupet kryesore të detajimit janë në përputhje me grupet përkuese në Indeksin e Çmimeve të Konsumit. Indekset krahasohen me periudhën bazë, 2010=100.

Peshat – Struktura e peshave në Tregtinë me Pakicë:

Ushqime, pije e duhan në njësi tregtare të jo të specializuara dhe të specializuara 28,4%

Artikuj jo-ushqimorë në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara 44,1%

Tregti me pakicë e hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara 27,5%

Modeli - Kampioni i ndërmarrjeve është zgjedhur nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, ku:

Kampioni për ndërmarrjet me 1 - 4 të punësuar është marrë me zgjedhje, ndërsa ndërmarrjet me 5 e më shumë të punësuar janë anketuar tërësisht.

Mbledhja e informacionit - Nga të dhënat mbledhen direkt nga ndërmarrjet me anketues të cilët plotësojnë pyetësin Anketat Tremujore pranë Ndërmarrjeve të Tregtisë.

Treguesit - Janë dhënë në formë indeksi, ndryshimi tremujor në përqindje, ndryshimi vjetor në përqindje me një vit referues bazë, aktualisht 2010=100. Të dhënat nuk paraqesin vlera absolute.

Indekset - Shprehin ndryshimin në kohë të një variabli të dhënë ose tërësi variablash. Indeksi i volumit është llogaritur me anë të formulës Laspeyres. Për të eliminuar ndikimin e çmimeve, indekset deflatohen me indeksin e çmimeve të konsumit për periudhat përkatëse sipas grupeve përkuese.

Ndryshimi vjetor në përqindje - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit të njejtë të një viti më parë.

Ndryshimi tremujor në përqindje - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit paraardhës të të njejtit vit.

Rishikimi – Indekset mund të rishikohen për disa arsye: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike ose rivlersime të koeficientëve të përdorur , etj.

Përkufizim i treguesit kryesor - Shifra e afarizmit përfshin shitjet mujore gjithsej që ndërmarrja realizon gjatë muajit nga shitja e produkteve apo shërbimeve përjashtuar Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH).